



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, Paneli i Gjykatës së Apelit ka planifikuar shqiptimin e aktgjykimit të apelit për të enjten, më 14 dhjetor 2023, në orën 9:30.

Shqiptimi i aktgjykimit të apelit do të mbahet në seancë publike dhe mund të përcillet prej përmes faqes së internetit të DHSK-së në tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte. Kërkohej regjistrim paraprak për personat që dëshirojnë ta ndjekin seancën nga galeria për publikun në Gjykatë.

Sipas Ligjit të DHSK-së, Paneli i Apelit mund ta lerë në fuqi, prapësojë, ose ndryshojë aktgjykimin e Trupit Gjykues.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 23 dhe 24 nëntor dha dëshmi dëshmitari i shtatë i thirrur prej Mbrojtjes, znj. Time Kadrijaj. Dëshmia e saj lidhej me periudhën përkatëse kur ajo ishte mjeke në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Më 27 nëntor, dha dëshmi dëshmitari i tetë i thirrur prej mbrojtjes, z. Andre De Villiers Horne. Ky dëshmitar dha dëshmi si ekspert kriminalistik. Dëshmitari i nëntë i thirrur prej Mbrojtjes dha dëshmi më 28 dhe 29 nëntor me videolidhje, nën masa mbrojtëse.

Në fund të seancës së ditës së djeshme, Trupi Gjykues caktoi 15 janarin 2024 si datën e synuar për mbylljen e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes. Seanca e radhës në këtë çështje gjyqësore është caktuar më 9 janar 2024, kur pritet të fillojë dëshminë një dëshmitar i ri i thirrur prej Mbrojtjes.

Më 22 nëntor 2023, Kryetare Trendafilova caktoi një panel të Gjykatës Kushtetuese për të marrë vendim mbi një kërkesë referuese të Mbrojtjes së Nasim Haradinajt. Paneli ftoi Prokurorinë t'i përgjigjet kërkesës referuese brenda 22 janarit 2024 dhe Mbrojtjen e Haradinajt të kundërpërgjigjet, nëse dëshiron, brenda 21 ditësh. Kërkesa referuese u dorëzua si konfidenciale dhe Paneli urdhëroi Mbrojtjen të dorëzojë versionin e redaktuar publik të saj.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, sikurse është raportuar tashmë në shumë media, më 17 nëntor Trupi Gjykues urdhëroi kufizimin e përkohshëm të komunikimeve dhe vizitave të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, dhe Rexhep Selimit. Vendimi i përkohshëm u mor në vijim të kërkesës së Prokurorisë për modifikim të kushteve të paraburgimit. Ai nuk ndikon në vizitat dhe komunikimet për shtatë të paraburgosurit e tjerë në objektin e paraburgimit.

Vendimi ndalon përkohësisht vizitat e këtyre tre të akuzuarve nga persona të paprivilegjuar dhe përcakton që çdo kërkesë për komunikim me persona të paprivilegjuar gjatë kësaj periudhe duhet të autorizohet paraprakisht nga Administratorja.





Trupi Gjykses vendosi se kufizimet janë të përshtatshme duke marrë parasysh rrezikun e nxjerrjes së paligjshme të informacionit konfidencial nga objekti i paraburgimit.

Kufizimet janë të përkohshme derisa Trupi Gjykses të lëshojë vendim të plotë lidhur me themelësinë e kërkesës së Prokurorisë.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykses miratoi më 27 nëntor Kërkesën e Prokurorit të Specializuar lidhur me Kontaktimin e Dëshmitarëve pas Dëshmisë, e cila lidhet me kontaktet mes një palë dhe dëshmitarit të thirrur nga pala tjetër, pasi dëshmitari ka përfunduar dëshminë ose pasi deklaratat e dhëna më parë prej tyre janë pranuar si prova.

Seanca e radhës në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënë, më 4 dhjetor, në orën 10:00.

Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, Ekaterina Trendafilova, u takua me përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë dje gjatë një aktiviteti komunikues dhe ndërgjegjësues në Prishtinë. Gjatë aktivitetit, ajo iu përgjigj pyetjeve, dëgjoi shqetësimet e pjesëmarrësve dhe shpjegoi mandatin dhe punën e Gjykatës. Po ashtu, ajo foli me studentë të drejtësisë dhe u takua me përfaqësues të OJQ-ve. Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim ka qenë pjesë përbërëse e strategjisë për komunikimi të DHSK-së që prej momentit që Gjykata filloi punën.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

